



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

POLITIKA E TRAJTIMIT TË GABIMEVE

Janar, 2017

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Bul. "Zhan D'ark", Nr. 3, Tirana, ALBANIA,

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al

Tabelë Përmbledhëse

1. Hyrje.....	2
2. Përkufizime	3
3. Kategoritë e gabimeve	4
4. Përgjegjësitë.....	4
5. Identifikimi i gabimeve.....	5
6. Korrigjimi i gabimeve	5
6.1 Rregullat e përgjithshme.....	5
6.2 Rregullat specifike në varësi të kategorisë së gabimit.....	5
7. Menaxhimi dhe arkivimi i gabimeve	8
7.1 Informacioni për gabimet e gjetura dhe korrigjimi i tyre	8
7.2 Analiza e gabimeve	8

1. Hyrje

Politika e Trajtimit të Gabimeve është një komponent i Parimet e Rishikimit të të Dhënave Statistikore dhe është në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane, parimet e Paanshmërisë dhe objektivitetit dhe Procedurat e duhura statistikore.

Parimi i Paanshmërisë citon se institutet e statistikave duhet të zhvillojnë, prodhojnë dhe të shpërndajnë statistika evropiane duke respektuar pavarësinë shkencore dhe profesionale me qëllim që të gjithë përdoruesit të trajtohen në mënyrë të barabartë.

Parimi i Procedurave të duhura statistikore citon se institutet e statistikave zbatojnë procedurat e duhura statistikore që nga procesi i mbledhjes se të dhënave deri tek vlerësimi i tyre, për të siguruar cilësinë e statistikave zyrtare.

Tek parimi i Paanshmërisë pika 6.3 përcakton nëse institutet e statistikave identifikojnë gabime në statistikat zyrtare të publikuara, ato duhen korrigjuar sa më parë të jetë e mundur dhe duhen publikuar përsëri duke njoftuar përdoruesit paraprakisht për ndryshimet.

Politika e Trajtimit të Gabimeve siguron një kornizë të përbashkët për menaxhimin e gabimeve, në të gjitha fushat e prodhimit statistikor, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së proceseve statistikore, produkteve, shërbimeve, si dhe imazhin e (Institutit të Statistikave) INSTAT.

Kjo politikë nuk është e njëjtë me Parimet e Rishikimit të të Dhënave Statistikore, e cila jep shpjegime pse mund të ndodhin ndryshimet në të dhënat statistikore. Rishikimet zakonisht raportohen në botimet dhe në tabelat e publikuara në faqen e internetit të INSTAT. Në rastin e gabime duhet që të prodhohet një informacion të dedikuar kësaj çështje.

Zbatimi i politikës së trajtimit të gabimeve mbështetet nga procedurat e brendshme të INSTAT, të cilat përfshijnë mekanizmat e brendshëm dhe të jashtëm të komunikimit, si dhe mjetet për korrigjimin e gabimeve dhe modelet e raportimit.

Operacionet e korrigjimit të gabimeve janë pjesë e rishikimeve të pa planifikuara, të përcaktuara në Politikën e Rishikimit të të Dhënave Statistikore, ku sipas përkufizimit, nuk janë shpallur më parë pasi janë rezultat i ngjarjeve të paparashikuara. Termi “të pa planifikuara” nuk ka të bëjë me shkakun e gabimit, por me numrin e herëve në të cilin rishikimi i gabimit është kryer, të cilat as nuk janë të përcaktuara në kalendarin e rishikimeve vjetore as nuk pasqyrohen në planet e publikimit.

Politika e Trajtimit të Gabimeve përqendrohet në trajtimin e gabimeve të përfshira në të dhënat dhe informacionet statistikore të shpërndara më parë.

2. Përkufizime

Sipas kësaj politike, gabimet janë informacione dhe të dhëna të pasakta statistikore, të shkaktuara nga përpunimi i gabuar i të dhënave, të cilat nuk janë zbuluar para publikimit të tyre dhe të cilat mund të ishin korrigjuar, nëse do të ishin gjetur në kohën e duhur. Politika e Trajtimit të Gabimeve përdor përkufizimet dhe termat specifike të mëposhtme:

Të dhënat statistikore janë të dhëna numerike, që merren nëpërmjet procedurave (të zgjedhjes së plotë ose të pjesshme) të vrojtimit statistikor. Nëpërmjet përpunimit statistikor të të dhënave përftojmë tregues primarë dhe të derivuar, mbartës të informacionit statistikor. Treguesit statistikor masin madhësinë, strukturën, intensitetin dhe variancën e një fenomeni të studiuar në kohë dhe hapësirë.

Informacioni statistikor në përgjithësi ka të bëjë me metadata statistikore. Në veçanti, përfshin simbole statistikore, komente, tabela, diagrama, shifra, përkufizime, shpjegime metodologjike dhe tekste të tjera që shpjegojnë përmbajtjen dhe rëndësinë e të dhënave statistikore. Në proceset e rishikimit të gabimeve ky informacion po ashtu duhet të korrigjohet.

Gabimi përkufizohet si shpërndarja e të dhënave dhe informacioneve të pasakta statistikore për përdoruesit për shkak të:

- keqpërdorimit të procedurave të përpunimit të të dhënave,
- gabimeve gjatë hedhjes së të dhënave ose mungesa e të dhënave në procesin e përpunimit.

Gabimet mund të identifikohen në të dhënat statistikore të publikuara kohët e fundit (të dhënat aktuale), si dhe në të dhënat statistikore të publikuara më parë (të dhënat e kaluara). Publikimi i të dhënave statistikore, që ka ndodhur në shkelje të konfidencialitetit statistikor ose e të dhënave të ndaluara për publikim, konsiderohet gjithashtu një gabim.

Rishikimet ose korrigjimet janë të përcaktuara gjerësisht si çdo ndryshim në të dhënat statistikore të vendosura në dispozicion të publikut. Në përgjithësi, të dhënat janë rishikuar për të përfshirë informacion të ri të përmirësuar dhe kështu rishikimet janë të pandara nga prodhimi statistikor. Për shembull, raportimi i të dhënave të përkohshme apo paraprake kur të dhënat në lidhje me një fenomen të caktuar janë kërkuar përmirësohet me informacionin përkatës në dispozicion, vetëm pas një periudhe të caktuar kohe.

Lidhja midis një gabimi dhe një rishikimi: Një gabim në të dhënat statistikore të publikuara, i cili duhet të korrigjohet në përputhje me Politikën e Trajtimit të Gabimeve, do të shkaktojë një rishikim të paplanifikuar të të dhënave statistikore për shkak se, në shumicën e rasteve, korrigjimi i gabimeve nuk mund të shpallet paraprakisht.

Personi përgjegjës për publikimin është personi i cili është drejtpërdrejt përgjegjës për punën statistikore, në bazë të një detyre të përcaktuar qartë.

3. Kategoritë e gabimeve

Për të siguruar një reagim të arsyeshëm ndaj gabimeve të publikuara, në përputhje me përkufizimin e paraqitur më parë, gabimet i kategorizojmë:

- 1) **Gabimet me një ndikim të papërfillshëm/parëndësishëm:** të dhëna të pasakta që nuk modifikojnë të dhënat e publikuara dhe informacionin (e gabuar). Ato përfshijnë, për shembull, gabime gramatikore, drejtshkrimore apo në formulim, hyperlink ? jo të plota, të cilat nuk ndikojnë në interpretim nga ana e përdoruesit.
- 2) **Gabimet me ndikim të vogël:** tabela, tekste ose grafik të të dhënave të pasakta:
 - a) rëndësia e të cilave është aq e vogël sa që përmbajtja e informacionit mbetet e pandryshuar (pavarësisht nga niveli i agregimit) ose
 - b) që ndodhin në çdo nivel agregimi dhe rëndësia e të cilave është e madhe dhe mjaftueshme për të ndryshuar përmbajtjen e informacionit, por që nuk janë në interes të publikut.
- 3) **Gabimet me një shkallë lartë ndikimi/kritike:** tabela, tekste ose grafik të dhënash të pasakta të cilat:
 - a) ndodhin në çdo nivel agregimi, rëndësia e të cilave është e madhe dhe mjaftueshme për të ndryshuar përmbajtjen e informacionit dhe janë me interes për publikun ose
 - b) kanë pasoja të rëndësishme ekonomike apo
 - c) paraqesin shkelje të mbrojtjes së të dhënave dhe konfidencialitetit.

4. Përgjegjësitë

Në varësi të kategorisë së gabimeve të identifikuara, ka shkallë të ndryshme të përgjegjësisë, pra:

- 1) Përgjegjësi i sektorit - Është përgjegjës për publikimin e të dhënave dhe informacioneve statistikore dhe rrjedhimisht është përgjegjës për dhënien e informacionit pse ka ndodhur gabimi. Në mungesë të përgjegjësit të sektorit, detyrat e tij/saj janë kryer nga personi i caktuar për këto detyra.
- 2) Drejtori i një drejtorie që prodhon statistikat/drejtori i përgjithshëm -Është përgjegjës për çështjet strategjike që lidhen me publikimin dhe rrjedhimisht, për çështjet strategjike që lidhen me korrigjimin e gabimeve të botuara. Në mungesë të tyre, detyrat e tyre janë kryer nga personat e caktuar për këto detyra.

3) Përgjegjësi për shpërndarjen/publikimin/komunikimin – Duhet të prodhojë informacion të dedikuar për përshkrimin e gabimit që ka ndodhur në këto drejtori. Në bashkëpunim me drejtorinë që ka prodhuar statistikat, hartojnë formave të ndryshme të informimit të përdoruesve.

5. Identifikimi i gabimeve

Një gabim mund të identifikohet brenda çdo njësie organizative të INSTAT ose nga përdoruesit e jashtëm të të dhënave dhe informacioneve statistikore. Pavarësisht nga mënyra e identifikimit të gabimit, përgjegjësi i sektorit ku është gjeneruar gabimi informohet nëpërmjet kanaleve të zakonshme të komunikimit. Nëse përgjegjësi i sektorit nuk mund të kontaktohet, informohet eprori.

6. Korrigjimi i gabimeve

6.1 Rregullat e përgjithshme

Në të gjitha rastet, drejtori i drejtorisë në të cilin është gjeneruar gabimi informon përgjegjësit e sektorëve të publikimit dhe komunikimit, në mënyrë që ata të jenë të vetëdijshëm për gabimin e ndodhur dhe të jenë të aftë për t'iu përgjigjur komenteve të përdoruesve. Përgjegjësi i sektorit, së bashku me drejtorin e drejtorisë dhe me personin përgjegjës, përcakton llojin e gabimit në përputhje me kategoritë e përcaktuara në pikën 3. Në çdo publikim të shtypur, në rast të zbulimit të gabimit, një përshkrim i shkurtër i gabimit do të publikohet në faqen e internetit të INSTAT.

6.2 Rregullat specifike në varësi të kategorisë së gabimit

Gabimet me një ndikim të papërfillshëm/parëndësishëm: korrigjohen pa i përmendur në njoftimet për shtyp, publikimet, në bazat e të dhënave në internet ose në faqen e internetit. Në rast se një gabim i tillë ndodh, nuk është e nevojshme paraqitja e informacionit të brendshëm dhe dokumentimi i gabimit. Me përjashtim të gabimeve sistematike, dokumentimi në sektorin përgjegjës është i mjaftueshëm. Nuk ka asnjë veprim të njoftimit aktiv për përdoruesit e njohur. Në rast të njoftimeve për shtyp, gabimi do të korrigjohet sa më shpejt të jetë e mundur dhe versioni i korrigjuar do të publikohet në faqen e internetit të INSTAT. Në rast të publikimeve të shtypura dhe elektronike, gabimi do të korrigjohet dhe do të futet në numrin e ardhshëm të publikimit. Në rastin e të dhënave të publikuara në bazat e të dhënave në internet, bazat e të dhënave të pasakta zëvendësohen me të saktat sa më shpejt të jetë e mundur. Në rastin e të dhënave dhe informacioneve të publikuara në faqen e internetit, gabimi do të korrigjohet zakonisht në rishikimin e ardhshëm të faqes përkatëse.

Gabimet me ndikim të vogël korrigjohen në njoftimet për shtyp, në versionin elektronik të botimeve, në bazat e të dhënave në internet dhe në faqen e internetit.

Në rastin e njoftimeve për shtyp, një shënim për korrigjimin do të përfshihet poshtë titullit, si “versioni i korrigjuar i ... (treguesi është përmendur)”, të dhënat e korrigjuara do të shkruhen me shkronja të theksuara dhe do të shoqërohen me shënimin ku thuhet se të dhënat e theksuara përfaqësojnë një korrigjim të të dhënave të publikuara më parë, duke përmendur numrin dhe datën e njoftimit për shtyp. Njoftimi i ri për shtyp do të postohet në faqen e internetit dhe do të zëvendësojë atë të mëparshëm.

Në rastin e publikimeve të shtypura, nuk do të rishtypet një botim i ri i korrigjuar, por një material përshkruar në lidhje me gabimin do të publikohet në faqen e internetit të INSTAT.

Në rastin e botimeve elektronike, versioni i gabuar do të zëvendësohet sa më shpejt që të jetë e mundur, duke përfshirë bashkangjitur file-t në Excel. Një shënim në të dhënat dhe/ose informacionin e korrigjuar në versionin elektronik, do të përfshihet në faqen e parë.

Në rastin e publikimit, sipas katalogut të botimeve, të shpërndarë edhe në formë elektronike dhe të shkruar, shënimi gjithashtu do tu referohet gabimeve në botim të shtypur.

Në rastin e të dhënave të publikuara në bazat e të dhënave në internet, bazat e të dhënave të pasakta do të zëvendësohen me ato të korrigjuara dhe hapësira e rezervuar për njoftimet do të përmbajë një shënim për të dhënat e korrigjuara.

Në rastin e të dhënave dhe informacioneve të publikuara në faqen e internetit, gabimet do të korrigjohen dhe faqja përkatëse do të zëvendësohet sa më shpejt që të jetë e mundur.

Në rastin e gabimeve me një shkallë lartë ndikimi/kritike, botimet dhe njoftimet për shtyp duhet të hiqen nga faqja e internetit dhe të korrigjohen sa më shpejt të jetë e mundur. Gabimet serioze në përmbajtje që janë zbuluar gjatë shpërndarjes, rëndësia e të cilave ka rënë dukshëm për shkak të vonesës në kohë krahasuar me periudhën e referencës, janë të përjashtuara nga ky rregull. Këto gabime më vonë janë subjekt i kriterëve të korrigjimit të gabimeve me një shkallë rëndësie të vogël. Në rastin e gabimeve me një shkallë lartë ndikimi/kritike, konsultimi do të kryhet me: përgjegjës të sektorit në fjalë, koordinatorin dhe drejtorin e përgjithshëm të INSTAT. Njësia përgjegjëse urgjentisht duhet të prodhojë një version të korrigjuar për shtypin dhe/ose publikimin dhe hartojë në vijim:

- një dokument që do të publikohet në faqen e internetit të INSTAT në lidhje me gabimin e zbuluar, shkaku e tij, mënyrën e korrigjimit dhe të produkteve që do të korrigjohen (njoftimet për shtyp, botimet elektronike dhe të shtypura, bazat e të dhënave, etj);
- një raport i brendshëm tregon shkaku e gabimit, mënyrën për ta zgjidhur atë, datën e korrigjimit dhe masat për parandalimin në të ardhmen të gabimeve të ngjashme.

Drejtoria e Integrimit European, Koordinimit të Projekteve dhe Publikimeve, me mbështetjen e drejtorisë prodhuese të dhënës statistikore, publikon dokumentin e përmendur më lart në faqen e internetit të INSTAT. Korrigjimi i përmendur duhet të jetë i dukshëm, mundësisht në faqen kryesore të internetit të INSTAT.

Drejtoria e Integrimit European, Koordinimit të Projekteve dhe Publikimeve, këshillon përdoruesit e rëndësishëm/të abonuarit në lidhje me gabimin. Përveç këtyre rregullave të përgjithshme, në varësi nga lloji i produktit të publikuar, zbatohen një seri rregullash të veçanta.

Në rastin e njoftimeve për shtyp, një shënim për korrigjimin do të përfshihet poshtë titullit, si “versioni i korrigjuar i ... (treguesi është përmendur)”, të dhënat e korrigjuara do të shkruhen me shkronja të theksuara dhe do të shoqërohen me shënimin ku thuhet se të dhënat e theksuara përfaqësojnë një korrigjim të të dhënave të publikuara më parë, duke përmendur numrin dhe datën e njoftimit për shtyp. Njoftimi i ri për shtyp do të publikohet në faqen e internetit duke zëvendësuar të mëparshmin dhe do të transmetohet tek përfituesit nëpërmjet të njëjtit kanal transmetimi.

Në rastin e publikimeve të shtypura, nëse publikimi është rishtypur, gabimi i korrigjuar shoqërohet me një shënim në një vend të dukshëm, zakonisht në të njëjtën faqe ku gabimi është korrigjuar. Nëse publikimi nuk është printuar, një material përshkrues në lidhje me gabimin do të bashkëngjitet me kopjet e pa shpërndara ende dhe materiali shkrimor do të publikohet në faqen e internetit. Vendimi për rishtypjen do të merret në bazë të analizës kosto-përfitim.

Në rastin e botimeve elektronike, versioni i gabuar zëvendësohet sa më shpejt të jetë e mundur, zakonisht në të njëjtën ditë, duke përfshirë bashkëngjitur file-t në Excel. Një shënim në të dhënat dhe/ose informacionin e korrigjuar në versionin elektronik do të përfshihet në faqen e parë dhe, nëse është e nevojshme, shkak i gabimit. Përshkrimi përmbledhës i publikimit elektronik në faqen e internetit do të përfshijë një referencë për gabimin, korrigjimet dhe datën e korrigjimit.

Në rastin e publikimit, sipas katalogut të botimeve, të shpërndarë edhe në formë elektronike dhe të shkruar, kur publikimi nuk është rishtypur, shënimi gjithashtu do të referohet gabimeve në botimin e shtypur.

Në rastin e të dhënave të publikuara në bazat e të dhënave në internet, bazat e të dhënave të pasakta do të zëvendësohen me ato të korrigjuara dhe hapësira e rezervuar për njoftimet do të përmbajë një shënim për të dhënat e korrigjuara.

Në rastin e të dhënave dhe informacioneve të publikuara në faqen e internetit, gabimet do të korrigjohen dhe faqja përkatëse do të zëvendësohet, maksimumi brenda 2 ditëve nga gjetja e gabimit. Në varësi të zgjidhjeve teknike, një shënim në të dhënat e korrigjuara/informacionit do të përfshihet dhe, nëse është e nevojshme, shkaqet e gabimit.

Gabimet, që janë një shkelje e mbrojtjes së të dhënave dhe konfidencialitetit, janë konsideruar gabime të mëdha me ndikim të lartë/kritike. Korrigjimi dhe komunikimi i gabimeve të tilla vendoset në përputhje me ligjin në fuqi, Nr.9180, datë 5.2.2004 “PËR STATISTIKAT ZYRTARE”, si dhe me dokumentet e tjera të caktuara legjislative për mbrojtjen e të dhënave dhe konfidencialitetit. Përfshirja e përgjegjësit të sektorit, drejtorit të drejtorisë përgjegjëse, drejtorit të përgjithshëm të INSTAT duhet të menaxhojnë këto gabime.

7. Menaxhimi dhe arkivimi i gabimeve

7.1 Informacioni për gabimet e gjetura dhe korrigjimi i tyre

Të gjitha kategoritë e gabimeve, përveç atyre me një shkallë të ulët të ndikimit/të parëndësishme dhe jo të rregullta, duhet të dokumentohen dhe të analizohen në përputhje me rregullat e menaxhimit dhe arkivimit të gabimeve, duke marrë masa për të parandaluar gabime të ngjashme në të ardhmen. Drejtoria përgjegjëse dhe stafi përgjegjës për shpërndarjen krijon dhe menaxhon një sistem të regjistrimit dhe arkivimit të gabimeve. Drejtoritë apo sektorët duhet të njoftohen, për korrigjimin e gabimeve nga drejtoria përgjegjëse dhe stafi përgjegjës për shpërndarjen, së bashku me informacionin e mëposhtëm: datën e zbulimit, datën e korrigjimit, kategorinë ose shkallën e rëndësisë, përshkrimin, shkakun, veprimin dhe masat e marra për të parandaluar ndodhjen në të ardhmen të gabimeve të ngjashme, në përputhje me një procedurë operative të sistemit. Dokumentet e prodhuar duke zbatuar procedurat e nevojshme publikohen në faqen e internetit të INSTAT.

7.2 Analiza e gabimeve

Një analizë e gabimeve është paraqitur çdo vit si pjesë e raportit të aktivitetit të INSTAT me qëllim parandalimin e ndodhjes së gabimeve dhe zvogëlimin e numrit të tyre.